



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR  
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR  
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR  
SHKOLLA E MESME ARTISTIKE "JAKOV XOXA"

Prot. 232

Fier, më 28.9.2024

Lënda: Njoftim për vend të lirë pune.

Drejtuar: ZVAP Fier

Në mbështetje të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, udhëzimit nr. 22, datë 13.11.2023 "Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për emërimin, uljen në detyrë, pezullimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe nëndrejtorit të institucionit publik arsimor parauniversitar" Kreu I, Neni 1, pika 2a, si dhe udhëzimit nr 14 datë 10.07.2023 " për numrin e nxenesve në klase dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar". shkolla " Jakov Xoxa" shpall 1 vend të lirë pune për pozicionin e ndrejtorit.

**1) Kandidatët për nëndrejtor të institucionit publik të arsimit parauniversitar duhet:**

- a) të zotërojë arsimim si mësues sipas përcaktimeve në nenin 57, të ligjit nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- b) të ketë të paktën kategorinë "Mësues i kualifikuar" me vlerësim jo më pak se "Mirë" në kualifikimin e fundit.
- c) të mos ketë masa disiplinore në fuqi.
- d) Të jetë certifikuar nga shkolla e drejtorëve pas përfundimit me sukses të trajnimit të detyrueshëm përgatitor për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar ose të jetë pranuar për ta kryer atë.

**2) Dokumentet që do të paraqesë aplikanti janë:**

- a) Jetëshkrim dhe kopjo të njëjsuar me origjinalin të dokumenteve që dëshmojnë pohimet në të (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.)

b) kopjo të njëhsuar me origjinalin të librezës së punës

c) kopjo të dokumentit të identifikimit.

d) tabelën e plotësuar me të dhëna për aplikant (sipas modelit në shtojcën 5 të udhëzimit.)

e) deklaratën e drejtuesit të IPAP ose vërtetim nga shkolla e drejtorëve që është pranuar për të kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor.

f) vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën 2 të udhëzimit)

g) vërtetim nga institucioni ku punon, që nuk ka masë disiplinore në fuqi.

h) deklaratën e konfliktit të interesit me punonjësit arsimorë të IPAP-së (bashkëshort/bashkëshorte, prind, vëlla/motër, fëmijë në moshë madhore, prindër të bashkëshortit/ bashkëshortes), sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 3, sipas Udhëzimit.

i) deklaratën për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati sipas shtojcës 8, të Udhëzimit;

Dokumentacioni i kërkuar në pikën 2, dorëzohet nëpërmjet shërbimit postar ose në rrugë elektronike në IPAP( e-mail: [shkollajakovxoxa@gmail.com](mailto:shkollajakovxoxa@gmail.com))

*Dorëzimi i dokumentacionit kryhet jo më vonë se 10 ditë pas shpalljes së njoftimit të vendit të lirë për nëndrejtor të insitucionit publik të arsimit parauniversitar në faqen elektronike zyrtare të ZVAP.*

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin Tuaj.



DREJTORI

Andi Bakiaj